



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 4 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 503 prot., datë 24.01.2024, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

1. Në lidhje me pyetjen tuaj të parë, ju informojmë se, vendimi nr. 78, datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit” i Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) është një akt që përcakton rregulla të përgjithshme lidhur me shqyrtimin e çështjes në apel duke parashikuar dispozita që lidhen me caktimin e datës dhe orës së çështjes, në përputhje me kalendarin e gjyqtarit relator si dhe rastet dhe procedurat mbi përshpejtimin e gjykimit të çështjeve.

2. Në lidhje me pyetjen tuaj të dytë, ju informojmë se me përfundimin e procesit të implementimit të Hartës së Re Gjyqësore, KLGJ ka vijuar me ndërmarrjen e masave të mëtejshme që lidhen me mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor e në veçanti hartimin e një plani strategjik për reduktimin e çështjeve të prapambetura në të gjitha gjykatat. Në Korrik 2023 është ngritur një grup pune me Urdhër të Kryetares së KLGJ i cili ka në përbërje anëtarë të Këshillit, gjyqtarë të të gjitha niveleve të gjykatave si edhe partnerë ndërkombëtar. Qëllimi i grupit të punës është identifikimi i shkaqeve të krijimit të stokut të çështjeve të prapambetura, hartimin e një plani veprimi dhe propozimi i masave konkrete për zgjidhjen dhe adresimin e tyre. Gjatë veprimtarisë së tij, nga ana e Grupit të Punës ndër të tjera janë hartuar dhe propozime konkrete për ndryshime ligjore me synimin për të thjeshtuar procedurat gjyqësore dhe për të përshpejtuar gjykimet e dosjeve gjyqësore. Po ashtu Këshilli po vijon me procedurat për plotësimin e vakancave në të gjitha gjykatat, me fokus të posaçëm në apel.

Për sa i përket kohëzgjatjes së efekteve negative që solli reforma në drejtësi, theksojmë se, një ndër sfidat më të rëndësishme me të cilat është hasur KLGJ gjatë veprimtarisë së tij lidhet me procesin e plotësimit të vendeve vakante në gjyqësor, në një kohë kur procesi i rivlerësimit kalimtar solli një ulje të ndjeshme të gjyqtarëve në sistem. Në kuadër të masave të marra nga KLGJ është arritur aktualisht funksionaliteti i plotë i Gjykatës së Lartë dhe ndërkohë, janë ulur ndjeshëm vakancat në të gjitha nivelet e tjera të gjykatave. Ndërsa, me krijimin e gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, Këshilli i kushtoi një rëndësi të veçantë caktimit dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, pranë këtyre gjykatave duke vijuar me ritme të shpejta për plotësimin e

vakancave të mbetura. Vetëm gjatë vitit të fundit janë emëruar në funksione gjyqësore 41 magjistratë të rinj të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës. Ndërkohë pritet që të përfshihen në sistemin gjyqësor edhe 140 gjyqtarë të rinj, deri në vitin 2027. Megjithatë, plotësimi i vakancave në sistemin gjyqësor është një proces kompleks dhe ndërvaret edhe nga faktorë të tjerë si procesi i verifikimit të pasurisë dhe figurës të magjistratëve të diplomuar, procesi i rivlerësimit kalimtar, numri i gjyqtarëve që pritet të mbushin moshën e pensionit, numri i gjyqtarëve që i nënshtrohen një procesi disiplinor apo kërkesat e mundshme për dorëheqje.

3. Në lidhje me pyetjen tuaj të tretë, ju informojmë se KLGJ përdor një sistem inovativ, i cili është mbështetur nga projekt i BE/KIE për “Forcimin e Efikasitetit dhe Cilësisë të Drejtësisë në Shqipëri”. Ky sistem i cili përmban pyetësorët në format elektronik është pilotuar dhe filluar zbatimin në vitin 2022, në Gjykatën e Shkallës së Parë për Juridiksionin e Përgjithshëm Tiranë për përdoruesit e saj. Ky pyetësor është jo vetëm detyrim ligjor, parashikuar në nenin 94, pika 5, shkronja ‘a’, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, por një nevojë e sistemit gjyqësor për të kuptuar cilësinë e shërbimeve të ofruara ndaj qytetarit dhe profesionistëve të drejtësisë.

Ky sistem/pyetësor në muajin Nëntor 2023 është prezantuar dhe implementuar në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë.

Pyetësi synon të nxjerrë në pah cilësinë aktuale të shërbimit gjyqësor si dhe t’i ofrojë informacion gjykatave dhe aktorëve të tjerë institucionalë për nivelin e përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve dhe reputacionin e gjykatës në këtë drejtim përpara qytetarëve. Nëpërmjet një ndërfaqeje, pyetësi mundëson gjenerimin e raporteve statistikore në mënyrë automatike. Platforma kryen përmbledhje sipas përcaktimeve të administratorit të platformës, të cilat më pas analizohet nga gjykata dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Të dhënat e pyetësorit përpunohen në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe aksesohen në adresat e mëposhtme:

-Pyetësi për Gjykatën e Shkallës së Parë për Juridiksionin e Përgjithshëm Tiranë - <https://pyetsor.com/klgj/index.php/458411>

-Pyetësi për Gjykatën e Shkallës së Parë për Juridiksionin e Përgjithshëm Vlorë - <https://pyetsor.com/klgj/index.php/623491>

4. Në lidhje me pyetjen tuaj të katërt, ju informojmë se, për vitin 2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka përpunuar të dhënat personale, në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Që prej lançimit të projektit më 22 prill, kanë dhënë opinionet e tyre 264 persona nga të cilët:

25% janë palë në proces,

24% subjekte të tjera të përfshira në proces si ekspertë, dëshmitarë, etj.,

24% përdorues të jashtëm të gjykatës.

27% e të anketuarve nuk kanë preferuar të cilësohen.

Në lidhje me pyetjet mbi mundësinë e aksesit dhe ambientet në gjykatë ju bëjmë me dije se 46.5% e të anketuarve mendojnë se gjykatat dhe ambientet e tyre janë lehtësisht të aksesueshme përkundrejt 9.4% të cilët vlerësojnë se gjykatat janë vështirësisht të aksesueshme, ndërsa 36.3 % nuk kanë preferuar të përgjigjen.

5. Lidhur më kërkesën tuaj për dokumentacionin mbi procedurën e përzgjedhjes për në Gjykatën e Lartë të z. {...}, znj. {...} dhe z {...}, ju bëjmë me dije se, e gjithë procedura e përzgjedhjes së kandidatëve është reflektuar në vendimet e arsyetuara për propozimin për emërim të tyre në Gjykatën e Lartë, të cilat gjenden të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në kategorinë Akte Administrative Individuale, të anonimizuara sipas legjislacionit në fuqi, si dhe mund t'i aksesoni në linket e mëposhtme:

-Vendim nr. 133, datë 06.02.2022 “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, nga rradhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}”, linku:

<https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/04/Vendim-i-arsyetuar-nr.133-P%C3%ABr-propozimin-p%C3%ABr-em%C3%ABrim-n%C3%AB-Gjykat%C3%ABn-e-Lart%C3%AB-t%C3%AB-kandidatit-.pdf>

-Vendim nr. 207, datë 09.06.2022 “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidates znj. {...}”, linku:

<https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/06/VENDIM-Nr.207dat%C3%AB-09.06.2022-P%C3%8BR-PROPOZIMIN-P%C3%8BR-EM%C3%8BRIM-N%C3%8B-GJYKAT%C3%8BN-E-LART%C3%8B-T%C3%8B-KANDIDATES-ZNJ.%E2%80%A6.pdf>

- Vendim nr. 208, datë 09.06.2022 “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatit z. {...}, linku:

<https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/06/VENDIM-Nr.208dat%C3%AB-09.06.2022-P%C3%8BR-PROPOZIMIN-P%C3%8BR-EM%C3%8BRIM-N%C3%8B-GJYKAT%C3%8BN-E-LART%C3%8B-T%C3%8B-KANDIDATIT-Z.%E2%80%A6.pdf>

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!